

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **“Avni Rustemi”**

Komuna: **Deçan**

Data: **25.07.2018**

Emri i kontratës: **Trajnim: Digjitalizimi i ditarëve**

Numri i kontratës: **ESIP/C1.3/01 - ESIP/SDG/01-CS/1.2.**

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **“Avni Rustemi”, fshati Irzniq, Komuna Deçan**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

- **Aftësim i mësimdhënësve në mirëmbajtjen e ditarëve dhe të dhënave të shkollës në formë elektronike.**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e shkollës **SHFMU “Avni Rustemi”, fshati Irzniq-Deçan** më së largu deri **03.08.2018**.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t’ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t’i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Ilirjana ÇEKAJ

Telefoni: 044/905/248

E-maili: Ilirjanaqekaj@live.com